

TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

BULETINI I KATËRT MJEDISOR DHE SOCIAL
FOURTH ENVIRONMENTAL AND SOCIAL BULLETIN

4



Tirana International Airport
Nënë Tereza



Dear readers,

Tirana International Airport (TIA) encourages individual action and shared responsibility towards the environment. This 4th edition of the Environment Brochure is designed to address key environmental themes, including waste reduction and recycling, water quality and conservation, air quality; all these are delicate themes

and factors that directly affect one of the main issues of this new century. Therefore, one of TIA's objectives is to inform the public about the best way to protect the environment and the actions taken toward this direction.

The aim of our engagement within the environmental sector is to offer feasible solutions to complex problems, bridging the gap between positive attitudes to the environment and every day actions. The focus of our publication is to show to the private businesses, to our clients and to the passengers that TIA is committed to continuously improve our environment. For example, we achieved to construct the extension of the terminal, a masterpiece that was inaugurated on September 2009 while being environmentally friendly to the highest possible extent. TIA for example offers ongoing checking of the implementation of a Construction Monitoring Program for Environmental Protection to ensure that all construction works were and are in accordance with the relevant Albanian regulations, international standards, and with the relevant permits.

We at TIA offer high standard facilities, safety, and security and comfort that target customer satisfaction. This is achieved while the airport operates with the least possible impact on the environment and local communities, and as a healthy, safe working environment for its staff. Continuous improvement is introduced in the areas of waste management by the effective implementation of waste recycling and by instructing and training TIA and third party maintenance staff. Continuous monitoring is another area where a lot of emphasis is put. In this context, we provide controls of water consumption, potable and waste water monitoring, monitoring of noise and noise zones, etc.

Our policy is to protect the community surrounding and to give our example by saving electricity and water or buying products which carry environmental labels or use less packaging for the sake of the environment. This was our promise. And we are keeping it.

Have a nice reading,

Andrea Gebbeken

Mesazh nga CEO

Të dashur Lexues,

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) mbështet si iniciativat individuale ashtu dhe ato të përbashkëta në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Ky Buletin i katërt Mjedisor është krijuar për t'u fokusuar mbi tematika kyçe në lidhje me mjedisin, duke përfshirë këtu reduktimin e mbeturinave, riciklimin, cilësinë dhe konservimin e ujit si dhe cilësinë e ajrit; të gjitha

këto janë tema dhe faktorë delikatë që ndikojnë në mënyrë direkte një nga çështjet më të rëndësishme të këtij shekulli. Për këtë arsye një nga objektivat e TIA-s është të informojë publikun mbi mënyrën më të mirë për të mbrojtur mjedisin dhe masat që duhet të ndërmerren në këtë drejtim.

Qëllimi i impenjimit tonë në drejtim të sektorit të mjedisit është të ofrojmë zgjidhje të qarta për probleme komplekse, duke arritur një ndërmjetësim midis sjelljeve pro mjedisit dhe veprimeve tona të përditshme. Fokusi i publikimit tonë është t'u tregojmë biznesit privat, klientëve tanë si dhe pasagjerëve, që TIA është e përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit. Për shembull ne arritëm të ndërtojmë zgjerimin e terminalit, një kryevepër e cila u përrua më shtator 2009, duke qenë të kujdesshëm ndaj mjedisit në maksimumin e përpjekjeve tona. Gjithashtu TIA ofron kontroll të vazhdueshëm të zbatimit të punimeve të ndërtimit nëpërmjet një Programi Monitorimi të Ndërtimit për Mbrojtjen e Mjedisit duke u siguruar se të gjitha punimet kanë qenë apo janë sipas rregullores përkatëse shqiptare, standardeve ndërkombëtare dhe rregulloreve përkatëse.

Ne në TIA ofrojmë shërbim të standardeve të larta, siguri dhe komoditet, të cilat synojnë kënaqësinë e klientit. Kjo arrihet ndërkohë që Aeroporti operon me impaktin më të vogël të mundshëm mbi mjedis dhe komunitetin përreth si dhe në një mjedis të sigurtë e të shëndetshëm pune për stafin e kompanisë. Përmirësimi i vazhdueshëm po vërehet në zonat e menaxhimit të mbeturinave nëpërmjet zbatimit të riciklimit të mbeturinave si rrjedhojë e direktivave dhe trajnimeve të TIA-s dhe palëve të treta të mirëmbajtjes. Monitorimi i vazhdueshëm është një tjetër fushë të cilës po i kushtohet një vëmendje e veçantë. Në këtë kontekst, ne ofrojmë kontrolle të konsumit të ujit, monitorime të ujit të pijshëm dhe mbeturinava të ujit, monitorime të zhurmave dhe zonave të zhurmave etj.

Politika jonë fokusohet në mbrojtjen e komunitetit përreth dhe dhënie të shembullit tonë nëpërmjet kursimit të energjisë elektrike dhe ujit, apo duke blerë produkte që nuk dëmtojnë mjedisin ose përdorin më pak mbështjellje për të ruajtur mjedisin. Ky ka qenë premtimi ynë. Dhe ne po e mbajmë atë.

Lexim të këndshëm,



table of contents

tabela e përmbajtjes

- p.2 **Message from the CEO**
Mesazh nga CEO
- p.4 **Main events & milestones**
Ngjarjet më të rëndësishme dhe momentet historike
- p.6 **Environmental and Quality Management System**
Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë
- Environmental monitoring and management
 - Monitorimi i mjedisit dhe menaxhimi
 - Monitoring and measurement
 - Monitorimi dhe sistemi i matjeve
 - Sustainable construction
 - Aktivitete ndërtimi sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm
 - Water management
 - Menaxhimi i ujit
 - Surface water and ground water
 - Ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë
 - Waste water and potable water
 - Ujërat e ndotur dhe uji i pijshëm
 - Waste management program
 - Programi i menaxhimit të mbetjeve
 - Noise monitoring
 - Monitorimi i zhurmave
 - Air quality management
 - Menaxhimi i cilësisë së ajrit
 - Natural environment
 - Mjedisi natyror
- p.14 **Safety Management & Emergency preparedness and response**
Menaxhimi i sigurisë dhe gatishmërisë në rastet e emergjencave
- Health & Safety
 - Shëndeti dhe siguria
- p.17 **Airport expansion & sustainable construction**
Zgjerimi i Aeroportit dhe aktiviteti i ndërtimit sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm
- p.18 **Customers**
Klientët
- p.21 **Social responsibility**
Përgjegjësia sociale
- p.23 **Key Figures for year 2009**
Shifrat për vitin 2009

Main events & milestones

Ngjarjet më të rëndësishme dhe momentet historike

**28 October 2008**

On this date, Greek Company Sky Express Airlines flew into Tirana International Airport (TIA) for the first time, adding another name to the list of carriers operating from Albania's only international airport.

12 November 2008

Belle Air began a new route between Tirana International Airport and Zagreb. On the day the new route began, a ceremony was held at the Airport to celebrate the beginning of this thrice weekly direct service.

17 December 2008

TIA won an Albanian Leadership Award. The prestigious award was given to TIA for demonstration of high social responsibilities. The Airport received the award in the category of Private Sector / Business for "offering a new vision for the metropolitan region of Albania". The award appraisal continues: "Beside the investments and the visible enlargement, TIA has changed the image of Albania in the eyes of visitors and of foreign tourists as an open, stable and dynamic country for domestic and foreign investments."

**19 February 2009**

A new service was installed for passengers at TIA. The new Tourist Information Point is open throughout the day. At the initiative of TIA, and in collaboration with Tirana Municipality and German Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ), the new information service opened on 19 February

28 tetor 2008

Më 28 tetor 2008 linja ajrore greke "Sky Express" u ul për herë të parë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), duke shtuar një emër tjetër në listën e operatorëve të transportit ajror të cilët operojnë në Aeroportin e vetëm Ndërkombëtar të Shqipërisë.

12 nëntor 2008

Linja ajrore "Belle Air" nisi një itinenar të ri fluturimi ndërmjet Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe atij të Zagrebit. Më 12 nëntor nisi ky shërbim i ri, dhe me këtë rast në aeroport u organizua një ceremoni për të festuar nisjen e këtij itinerari direkt nga Tirana në Zagreb me një shërbim tre herë në javë.

17 dhjetor 2008

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës fitoi çmimin e "Leadershipit Shqiptar". Ky çmim prestigjioz iu dha Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës për demonstrimin e përgjegjësisë të larta shoqërore. TIA e mori këtë çmim në kategorinë e Sektorit Privat/Biznes për "Paraqitjen e një Vizioni të ri për Zonën Metropolitane të Shqipërisë". Vlerësimi për çmimin vazhdon me deklarinimin se: "Përtej investimeve dhe një zgjerimi të dukshëm, TIA ka ndryshuar imazhin e Shqipërisë në sytë e vizitorëve dhe turistëve të huaj si një vend i hapur, i qëndrueshëm dhe dinamik për investimet vendase dhe të huaja.

19 shkurt 2009

Një shërbim i ri për pasagjerët është ofruar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës. Zyra e Informacionit Turistik brenda në terminal qëndron e hapur gjatë gjithë kohës. Me iniciativën e TIA-s dhe në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe GTZ-në, ky shërbim i ri informacioni u hap më 19 shkurt të 2009. Pasagjerët që udhëtojnë përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës mund të marrin informacion mbi Shqipërinë, rreth historisë, arkeologjisë, monumenteve të kulturës dhe sugjerime për të vizituar vendet turistike të Shqipërisë. Duke siguruar këtë shërbim, TIA është duke vazhduar përpjekjet për të promovuar vendin në gjithë botën.

11 mars 2009

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit Berlin 2009. Arritjet e dukshme të TIA-s u paraqitën për të tretin vit rradhazi në Berlin. Nga 11 marsi deri më 15 mars 2009, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës paraqiti arritjen e evidencave dhe një potencial të madh të rritjes së tregut kryesor botëror të lëvizjes së udhëtarëve. TIA e mbështet këtë ngjarje të medias ndërkombëtare si një instrument të vlefshëm për promovimin e potencialeve dhe tërheqjes së vëmendjes ndërkombëtare në drejtim të Shqipërisë duke demonstruar angazhimin e vazhdueshëm të aeroportit për të reklamuar zhvillimin ekonomik dhe të turizmit në Shqipëri.

2009. Passengers travelling through the Airport can obtain information on Albania, its history, archaeology and cultural monuments, and suggestions for places to visit in this beautiful country. In providing this service, TIA is continuing its efforts to promote Albania worldwide.

11 March 2009

TIA participated at the International Tourism Fair Berlin 2009. The company's remarkable achievements were presented in Berlin for the third successive year. From 11-15 March 2009, TIA presented its record achievements and huge potential for growth at the world's leading travel trade show, International Tourism Fair in Berlin (ITB). The company founds this international media event a valuable instrument in promoting its potential and attracting international attention towards Albania, demonstrating the Airport's continuous engagement to promote Albania's economic and tourism development.

1 April 2009

Tirana International Airport successfully tested an emergency situation in a simulation. The exercise involved Albania's General Directorate of Civil Emergencies (Ministry of Interior), the Fire Department, First Aid Unit, hospitals, police and army and some 100 volunteers. Officials from the country's Civil Aviation Authority, local authorities, Police Assistance Mission of the European Community to Albania (PAMECA) and Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE) were also present during the exercise.

10 June 2009

TIA expanded its aircraft portfolio with the arrival of an Airbus 310-300 freighter. For the first time, this large cargo aircraft operated by Turkish Airlines landed at the Airport on 10 June 2009. The Airbus ships cargo between Turkey, Italy and Albania.

14 June 2009

A new route was put into operation between the capital city of Albania and the largest city in the United States. TIA yet again demonstrates it is assisting Albania become better connected to the rest of the world. Scanderbeg Air is using a B767-200 aircraft for the service, which is operated by Sky King Inc. The test flight from JFK New York to Tirana took place on 1 June 2009.

12 August 2009

Travelling and fundraising found a perfect match at Tirana International Airport through TIA's support for Caritas Albania. Through careful positioning of collection boxes in TIA's new terminal, passengers and staff donated EUR 8,500 to people in need through a joint initiative of TIA and Caritas Albania.

20 August 2009

TIA successfully tested its new expanded terminal. All security measures and airport procedures ran smoothly, and the Phase B terminal extension drew approval of passengers ahead of the inauguration ceremony that took place the following month.

1 prill 2009

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës testoi me sukses gatishmërinë e kapaciteteve të tij nëpërmjet realizimit të një simulimi për situata emergjence. Në këtë ushtrim, u përfshinë struktura të tilla si: Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (Ministria e Brendshme), Departamenti i Zjarrfikëses, Njësia e Ndihmës së Shpejtë, Shërbimi Spitalor, Policia, Ushtria dhe rreth 100 vullnetarë. Të pranishëm në momentin e testimit ishin edhe zyrtarë nga Autoritetet e Aviacionit Civil, pushteti lokal, Misioni i Asistencës së Policisë të Bashkimit Evropian në Shqipëri. (PAMECA), dhe nga Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE).

10 qershor 2009

TIA zgjeron portofolin e avionëve me mbërritjen e një modeli të ri avioni "Airbus A310-300" për transport mallrash. Për të parën herë ky avion i madh, nën drejtimin e linjës ajrore Turkish Airlines u ul në Aeroport më 10 qershor 2009. Modeli i avionit "Airbus A310-300" transporton mallra midis Turqisë, Italisë dhe Shqipërisë.

**14 qershor 2009**

Një itinenar i ri filloi të funksionojë midis kryeqytetit shqiptar dhe qytetit më të madh të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. TIA vazhdon përpjekjet e saj për të ndihmuar Shqipërinë në rritjen e ndërlidhjes me pjesën tjetër të botës. Linja ajrore Scanderbeg Air ofron shërbimin e saj me një avion B767-200 nën drejtimin e kompanisë Sky King Inc. Fluturimi eksperimental nga JFK New York drejt Tiranës u krye më 1 qershor 2009.

12 gusht 2009

Grumbullimi i fondeve për bamirësi dhe udhëtimi i pasagjerëve formojnë një harmonizim perfekt në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës duke mbështetur në këtë mënyrë Karitasin shqiptar. Nëpërmjet vendosjes së kutive për grumbullim fondesh në terminalin e ri të TIA-s, pasagjerët dhe stafi dhuruan 8,500 EUR për njerëzit në nevojë nëpërmjet një iniciative të përbashkët të TIA-s dhe Karitasit Shqiptar.

20 gusht 2009

TIA testoi me sukses zgjerimin e terminalit. Të gjitha masat e sigurisë dhe procedurat e Aeroportit kaluan pa vështirësi dhe Faza B e zgjerimit të terminalit mori aprovimin e pasagjerëve përpara ceremonisë zyrtare të përfundimit që u zhvillua muajin në vijim.

9 September 2009

Mission fulfilled for Tirana International Airport with the inauguration of the extension of the new terminal, which itself is only two years old. This milestone marked the end of Phase B of the Airport's modernization and development. The extension was inaugurated at a gala ceremony attended by nearly 300 guests, including Prime Minister Professor Dr. Sali Berisha, state senior officials, Dr. Peter Noé (Board Member of HOCHTIEF AG), Dr. Reinhard Kalenda (TIA Chairman) and representatives of Company shareholders, business partners and employees.

30 September 2009

The Airport once again demonstrated its commitment to Albania's cultural life by supporting two arts and culture events. Supporting cultural experiences is just one of the development goals of TIA. In pursuing this goal, the Airport provided funds to the holding of the 4th Tirana International Contemporary Art Biannual (TICAB) and German October 2009. The sum was awarded to encourage widespread participation of citizens in the cultural life of the country.

**9 shtator 2009**

Misioni u përmbush për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës me përfundimin e zgjerimit të terminalit të ri për një afat kohor vetëm dy-vjeçar. Ky moment historik shënoi përfundimin e Fazës B të zhvillimit dhe modernizimit të Aeroportit. Zgjerimi i terminalit u përfundua në një ceremoni gala ku morën pjesë rreth 300 të ftuar duke përfshirë Kryeministrin e vendit Prof. Dr. Sali Berisha, zyrtarë të lartë të shtetit, Dr. Peter Noé (Anëtar i Bordit të HOCHTIEF AG), Dr. Reinhard Kalenda, (Drejtor i Përgjithshëm i Bordit Drejtues për TIA-n) dhe përfaqësues të shoqërive akcionere, partnerë biznesi si dhe punonjësit e TIA-s.

30 shtator 2009

Aeroporti tregoi përsëri angazhimin e tij ndaj jetës kulturore shqiptare duke mbështetur dy ngjarje të artit dhe kulturës. Mbështetja e përvojave kulturore është vetëm një nga objektivat e zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA). Në vazhdim të këtij objektivit, aeroporti kohët e fundit siguroi fonde në drejtim të organizimit të edicionit të katërt të "Binales Ndërkombëtare të Artit Bashkëkohor" dhe "Javës së Kulturës Gjermane" në Shqipëri. Mbështetja synonte inkurajim në pjesëmarrjen e gjerë të qytetarëve në ngjarjet kulturore dhe artistike të vendit.

**Environmental and Quality Management System****Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë**

Tirana International Airport's Quality Policy and Environmental, Health and Safety Policy are implemented through its Environmental and Quality Management System (EQMS), according to ISO 9001 and ISO 14001, respectively.

In compliance with these policies, TIA is focused on providing:

- high standard facilities, safety, security and comfort that target customer satisfaction;
- Airport operations with the least possible impact on the environment and local communities, and a healthy, safe working environment for its staff.

The priority areas identified by TIA include the effective implementation of the EQMS, assuring, maintaining and continually improving service quality at the Airport in compliance with environmental standards, occupational health and safety requirements. In this framework, quality and environmental internal audits, inspections and follow-ups of corrective and preventative actions for TIA's and third parties' op-

Politika e Cilësisë dhe Politika e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës janë zbatuar përmes Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë, përkatësisht në përputhje me Standardet e Cilësisë ISO 9001 dhe ato të Mjedisit ISO 14001.

Në përputhje me këto politika, TIA është fokusuar në plotësimin e:

- standardeve të larta të shërbimeve, sigurisë, kontrollit, dhe komoditetit që kanë si synim përmbushjen e kërkesave të klientit;
- kryerjen e operimeve në aeroport me ndikimin më të vogël të mundshëm në mjedis dhe komunitetin lokal si dhe sigurimin e një mjedisi pune të shëndetshëm dhe të sigurtë për punonjësit.

Fushat prioritare të identifikuar nga TIA përfshijnë zbatimin e efektshëm të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë në sigurimin e mirëmbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit në Aeroport, në përputhje me standardet mjedisore,

erations are carried out. A further priority is the implementation of the Environmental, Health & Safety and Social Action Plan (EHSSAP) 2005-2010, which was updated and detailed in the framework of the Airport expansion, defining specific actions and targets for each management issue and respective program, including the following:

- Environmental Management System: Revision of Environmental & Quality Management Manual, Airport Emergency Plan, Standard Operating Procedures
- Environment Policy and Awareness Training: Quality, Environmental, Health and Safety training
- Construction Monitoring: Ongoing checking of the implementation of the revised Construction Monitoring Program for Environmental Protection to ensure that all construction works for the Phase B project were in accordance with the relevant Albanian regulations and international standards, and with the relevant permits
- Waste management: Continuous improvement of waste management and infrastructure (project design for urban, recycled and hazardous waste collection site), effective implementation of recycling program, and instructing and training of TIA and third party maintenance staff on hazardous waste management
- Water and Air Quality: Continuous potable and waste water monitoring, and air quality monitoring. Control of water consumption
- Noise: Monitoring of noise and noise zones
- Soil: Soil protection measures
- Refuelling: Collaboration with fuel provider during the preparation phase for construction of the fuel farm within the Concession Area; improvement of fuel consumption management
- Flora and Fauna: Bird and pest management; Wildlife Habitat Program; conduction of Wildlife Habitat Mitigation Study
- Landscape management: Improvement and maintenance of landscaping; continuation with upgrading works of airfield
- Health and Safety Training: Provision and inspection on use of personal protective equipment for TIA staff and third parties
- Social Facilities: Continuation of improvements to maintenance workshop and facilities; renovation of Rescue and Fire Fighting Station including a gymnasium

Environmental monitoring and management

TIA carries out regular monitoring of the environment (water, waste, air quality, noise, energy and wildlife) to check progress with the overall policy commitments to prevent or minimize environmental impacts in the airport vicinity and identify if and where corrective actions are needed.



kërkesat ndaj shëndetit dhe sigurisë në punë. Në këtë kuadër janë kryer kontrolle të brendshme, inspektime, dhe një vazhdimësi veprimesh korrigjuese dhe parandaluese përsa i përket punës së kryer në TIA si edhe ndaj palëve të treta. Një tjetër prioritet është dhe zbatimi i Planit të Veprimit të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë dhe Social 2005-2010, i cili ishte përditësuar dhe detajuar në kuadër të zgjerimit të aeroportit duke përcaktuar veprimet specifike dhe objektivat për çdo çështje menaxhimi dhe programi përkatës duke përfshirë sa vijon:

- Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit: Rishikimi i Manualit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë dhe Planin e Emergjencës së Aeroportit, Procedurat Standarde të Operimit
- Politikat për Mjedisin dhe Trajnime Ndërgjegjësuere: Trajnime për Mjedisin, Cilësinë, Shëndetin dhe Sigurinë
- Monitorimin e ndërtimeve: Kontrollin në vazhdimësi të zbatimit të Programit të rishikuar të Monitorimit të Ndërtimeve për Mbrojtjen e Mjedisit për t'u siguruar se të gjitha punimet e ndërtimit për Fazën B ishin në përputhje me rregulloret përkatëse shqiptare, standardet ndërkombëtare dhe me lejet përkatëse
- Menaxhimin e mbetjeve: Përmirësimi i vazhdueshëm në drejtim të menaxhimit të mbetjeve dhe infrastrukturës (Skicimin e një projekti për grumbullimin e mbetjeve urbane të riciklueshme dhe për vendndodhje të caktuar për mbetjet e rrezikshme), zbatimi me efektivitet i programit për riciklimin e mbetjeve, udhëzimeve përkatëse dhe trajnimi i punonjësve të TIA-s dhe stafit të mirëmbajtjes mbi menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme
- Ujin dhe Cilësinë e Ajrit: Monitorimi i vazhdueshëm i ujit (ujit të pijshëm dhe ujërave të shkarkimeve urbane) dhe monitorimi i cilësisë së ajrit. Kontroll i konsumit të ujit
- Zhurmat: Monitorimi i zhurmave dhe konturi i zhurmave
- Tokën: Masat mbrojtëse ndaj tokës
- Furnizimin me karburant: Bashkëpunim me kompaninë e shërbimit të furnizimit me karburant gjatë fazës përgatitore për ndërtimin e pikës së karburantit brenda zonës së koncesionit; përmirësim i menaxhimit të konsumit me karburant
- Florën dhe Faunën: Zogjtë dhe menaxhimi i organizmave të dëmshme; Programi i studimit të Habiteteve të florës dhe faunës; Kryerja e Studimit të habiteteve të botës së gjallë (faunës dhe florës) së egër migratore
- Menaxhimin e peisazheve: Përmirësimi dhe mirëmbajtja e peisazheve, vazhdim i punës përmirësuese në zonën ajrore
- Trajnimin për Shëndetin dhe Sigurinë: Marrja e masave dhe kryerja e inspektimeve mbi përdorimin e Pajisjeve Personale Mbrojtëse për stafin e TIA-s dhe palët e treta
- Shërbimet sociale: Vazhdim i përmirësimit të ambientit të mirëmbajtjes dhe kryerjes së shërbimeve; rinovim i shërbimit të zjarrfikëses duke përfshirë dhe një palestër.

Monitoring and measurement

All areas of significant activity are included in TIA's monitoring and measurement regime. The Company's environmental monitoring program is conducted in accordance with monitoring procedures and management practices to ensure compliance with applicable regulations and standards. The results of the noise, air and water monitoring program for the Airport are summarized later in this document.

Sustainable construction

The last year has seen an expansion of the Airport, and therefore special attention was paid early on to proper implementation of a Construction Monitoring Programme for Environmental Protection. Even with the increase in air traffic movements, other operations and construction activities, the measurements were found to be more than satisfactory, falling well within the standard limits. However, such results were expected due to the preparation of an environmental assessment report prior to the start of Phase B construction. The mitigation measures foreseen in the report were applied strictly by the construction companies to limit air emissions. Meanwhile, the Quality, Environment, Health and Safety (QEHS) Department undertook audits and inspections for provision of compliance with EHSSAP.



Water management

TIA carries out on a continuous basis water quality monitoring and checks of water consumption. Analysis are carried out by the Laboratory of the Institute of Public Health and the Directorate of Public Health and Sanitary Inspectorate of Tirana. All members of the TIA community (employees, third parties, etc.) are responsible for limiting water consumption in their working area as well as in other airport facilities.

Surface water and ground water

Within the framework of the works comprising the Phase B project, the drainage system was upgraded in areas where a new workshop was set up in the airfield and where new facilities such as the fuel farm were to be built.

Waste water and potable water

Waste water from TIA premises is discharged to the Waste Water Treatment Plant ("WWTP"). This water is monitored according to parameters defined in TIA's internal guidelines on Water Quality Monitoring and the respective environmental permit. Monthly sampling and checks are carried out by the Institute of Public Health. The physico-chemical analysis includes measuring Biochemical Oxygen Demand (BOD), Chemical Oxygen Demand (COD), Suspended Solids (SS), acidity (pH), total phosphate (Ptotal) and ammonia (NH₄⁺). All sewage produced from airport buildings, as well as effluents from aircraft, treated in the

Monitorimi i mjedisit dhe menaxhimi

TIA kryen monitorime të rregullta të aspekteve mjedisore si: uji, mbetjet urbane, cilësisë së ajrit, nivelet e zhurmave, energjisë, florës dhe faunës për të kontrolluar progresin kundrejt angazhimeve të përgjithshme politike në mënyrë që të parandalojë ose zvogëlojë ndikimet mjedisore në afërsi të aeroportit dhe të identifikojë ku duhet të kryhen veprimet korrigjuese nëse ato janë të nevojshme.

Monitorimi dhe sistemi i matjeve

Të gjitha hapësirat e veprimtarive të rëndësishme janë përfshirë nga një sistem matjesh dhe monitorimi. Programi monitorues i kompanisë për çëshjet mjedisore është kryer sipas procedurave të procesit të monitorimit dhe praktikave menaxhuese për të siguruar përmbushjen e standardeve dhe rregulloreve të zbatueshme. Rezultatet për programin e monitorimit të zhurmave, ajrit dhe të ujit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës janë përmbledhur shkurtimisht në këtë dokument.

Aktivite ndërtimi sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm

Vitin e kaluar Aeroporti ka pësuar një zgjerim dhe si qëllim i është kushtuar një vëmendje e veçantë zbatimit korrekt të Programit të Monitorimit të Ndërtimit në lidhje me Mbrojtjen e Mjedisit. Me rritjen e lëvizjes së trafikut ajror, operimeve të tjera dhe aktivitetit të ndërtimit, matjet e kryera rezultuan të jenë më shumë se të kënaqshme, pra brenda kufijve standard. Ndërkohë, këto rezultate ishin të pritura që nga koha e përgatitjes së raportit paraprak të vlerësimit mjedisor para fillimit të Fazës B. Masat zbutëse të parashikuara në raport janë zbatuar saktësisht nga firma e ndërtimit për të ndaluar shkarkimet ndotëse të tepërta në ajër. Departamenti i Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë ka ndërmarrë audite dhe inspektime përsa i përket përmbushjes së kushteve në lidhje me Planin e Veprimit të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë dhe Social.

Menaxhimi i Ujit

TIA kryen vazhdimisht monitorimin e cilësisë së ujit dhe kontrollin e konsumit të ujit. Analizat kryhen nga Laboratori i Institutit të Shëndetit Publik, Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Inspektoriati Sanitar i Tiranës. Të gjithë anëtarët e komunitetit të TIA-s (punonjës, palët e treta, etj) janë përgjegjës për kursimin e ujit në mjediset e punës si edhe në shërbimet e tjera të aeroportit.

Ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë

Gjatë punimeve të Fazës B është përmirësuar sistemi kullues i ujërave të zonës, është ndërtuar një mjedis i ri punë në zonën ajrore si dhe janë në plan për t'u ndërtuar dhe rinovuar objekte të tilla si pika e karburantit.

Ujërat e ndotur dhe uji i pijshëm

Ujërat e ndotura shkarkohen nga godinat e TIA-s në Impiantin e Trajtitit të Ujërave të Zeza. Uji është monitoruar sipas parametrave të përcaktuara në procedurën e brendshme të TIA-s për Monitorimin e Cilësisë së Ujit dhe në përputhje me lejen përkatëse mjedisore. Marrja e mostrave dhe kontrolli i tyre një

WWTP are found to comply with both Albanian and EU standards. The technology employed in the plant ensures secure, environmentally-friendly wastewater disposal and represents a further contribution to water and environmental protection of habitats along the river Tërkuza near the Airport.

Some other measures taken by TIA to ensure compliance with standards include the following:

- extension of the oil separator and/or the de-icing separator in the apron extension and new workshop facility in the airside
- use of biologically-degradable detergents for aircraft cleaning
- updating of the inventory of cleaning detergents used, including usage by third parties
- purchase and use of environmentally-friendly de-icing substances

The quality of potable water at the Airport is monitored systematically through regular testing by the Directorate of Public Health and Sanitary Inspectorate. Analysis included biochemical testing for the presence of nitrites (NO₂⁻), nitrates (NO₃⁻), NH₄⁺, water hardness and bacteria harmful to human health.

Results show that the potable water at the Airport is suitable for drinking. Meanwhile, TIA is taking every possible measure to limit water consumption on its premises as well as prevent any situation that might lead to pollution.

Waste management program

The targets of this program are to minimize the amount of waste produced at the Airport and control the disposal of waste by third parties. Based upon EHSSAP a Waste Management Concept, aiming at minimizing waste through recycling, has been developed and is applied at TIA: waste separation is promoted to optimize recycling and reduce environmental impacts.

On each day between 25 and 30 m³ of waste were collected, of which 25-30 per cent are recycled. Specialized, licensed companies provide services to TIA for the removal of recyclable waste and non-recyclable waste, in compliance with legislation in force and waste management procedures.

Hazardous waste and substances generated at the Airport are stored temporarily in full accordance with legal requirements. Specialized, licensed Albanian companies collected 1300 litres of used oil and 26 used 12V batteries, which had been stored temporarily at TIA facilities during 2009. The amount collected and stored during 2009 was transferred by licensed companies to their licensed facilities.

The construction companies for Phase B properly disposed of construction waste at a dump site approved by the local authorities in compliance with the relevant legislation. TIA undertook measures to improve waste management equipment on site, including purchase of automatic outdoor cleaning vehicles, a new cleaning van, etc.

herë në muaj kryhet nga Instituti i Shëndetit Publik. Analizat fiziko-kimike përfshijnë vlerësimin e Nevojës Biologjike për Oksigjen (NBO), Nevojën Kimike për Oksigjen (NKO), lëndët pezull, aciditet (pH), fosfate (Ptotal), amoniak (NH₄⁺). Të gjitha ujërat e zeza të prodhura nga godinat e aeroportit dhe nga efluentët e avionit, trajtohen në Impiantin e Trajtitit të Ujërave të Zeza dhe rezultatet janë në përputhje me standardet shqiptare dhe ato të BE-së. Teknologjia e funksionimit të impantit siguron largimin e ujërave të zeza në mënyrë miqësore me mjedisin duke kontribuar ndaj mbrojtjes së ujit dhe mbrojtjes së habitateve në gjatësinë e lumit Tërkuza pranë aeroportit.

Disa nga masat e marra nga TIA për të siguruar plotësimin e standardeve janë si më poshtë:

- shtimin e ndarësve të vajit dhe ndarësve për procesin e shkrirjes së akullit me zgjerimin e pistës dhe faciliteteve që ofrohen në zonën ajrore
- përdorimi i detergjentëve të bio-degradueshëm për pastrimin e avionëve
- përditësimi i inventarit të përdorimit të detergjentëve të pastrimit duke përfshirë edhe palët e treta
- blerje dhe përdorimi substancave miqësore me mjedisin për procesin e shkrirjes së akullit nga avionët

Cilësia e ujit të pijshëm të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës monitorohet sistematikisht nga Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Inspektoriati Sanitar i Tiranës nëpërmjet testimeve të rregullta. Analizat përfshijnë ekzaminim biokimik për praninë e nitriteve (NO₂⁻), nitrateve (NO₃⁻), amoniakut (NH₄⁺), fortësinë e ujit dhe bakteret e dëmshme për shëndetin e njeriut.

Rezultatet tregojnë se uji i pijshëm në aeroport është i përshtatshëm për t'u pirë. TIA është duke marrë çdo masë të mundshme për kursimin e ujit për konsum në godinat e Aeroportit si edhe parandalimin e çdo situatë që mund të çojë drejt ndotjes.

Programi i menaxhimit të mbetjeve

Objektivat e këtij programi janë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit të sasisë së mbetjeve të prodhuara në Aeroport dhe kontrollojnë largimin e mbetjeve nga palët e treta. Në bazë të Planit të veprimit, Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë dhe Social koncepti për menaxhimin e mbetjeve ka si qëllim minimizimin e mbetjeve nëpërmjet ricikimit i cili ka qenë i zhvilluar si metodologji dhe zbatohet në TIA: ndarja e mbetjeve është promovuar për të optimizuar riciklimin dhe reduktimin e ndikimeve në mjedis. Çdo ditë grumbullohen 25 deri në 30m³ mbetje nga të cilat 25-30% janë mbetje të riciklueshme. Kompani të licënuara dhe specializuara sigurojnë shërbime për



The implementation of a collection site project designed for urban, recycled and hazardous waste, and effective implementation of the recycling program, instructing and training of TIA and third party maintenance staff on hazardous waste management is aimed at continuous improvement of waste management and infrastructure at the Airport.



Noise monitoring

In recent decades, the global air traffic, including Albania, has recorded considerable increase in the number of air traffic movements. By its very nature air transport links countries and what happens in one happens in the others. Thus, Albania has been introduced to new engine types that help it face the challenges to the environment from aircraft operations. Against this background, especially given the rapid increase in the number of flights in the country, noise pollution has become an important issue here.



To obtain data on noise pollution levels in the neighbourhood of airport, a measurement program has been implemented by TIA for the third consecutive year. The aim of the program is to sample and calculate day time and night-time average noise levels in the vicinity of the airport. Noise measurements record all noise



events at a site and are separated into those from aircraft and non-aircraft sources.

The program provides a description of the measurement process, a description of the specific sites selected for noise measurement and a quantitative analysis of the noise measurement results. Sites were chosen in order to assess noise in a variety of settings, encompassing sites within the Airport and those from the immediate vicinity, including residential areas.

The measurement programme is in compliance with the Company's environmental permit and the following national / EU legislation:

- Law No. 9774, dated 12.07.2007 "On the evaluation and management of environmental noise"
- Decision of the Council of Ministers (DCM) No. 103 dated 31.3.2002 "On Environment Monitoring"
- Guideline No.8, dated 27.11.2007 "On noise limits in specific environments"
- Directive 2002/30/EC of the European Parliament and of the Council of the European Union of 26 March 2002 "On the establishment of rules and

TIA-n për largimin e mbetjeve të riciklueshme dhe jo të riciklueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me procedurat përkatëse të menaxhimit të mbetjeve.

Mbetjet e rrezikshme dhe substancat e gjeneruara në aeroport janë magazinuar përkohësisht në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Kompani shqiptare të licensuara dhe të specializuara, kanë grumbulluar mbetje të rrezikshme të tilla si: 1300 litra vaj i përdorur, 26 bateri 12v të përdorura, të cilat kanë qenë magazinuar përkohësisht në objektet e TIA-s gjatë vitit 2009. Sasia e vajit të përdorur dhe baterive të grumbulluara gjatë vitit 2009 u transferua në objektet e këtyre kompanive të licensuara për këtë shërbim.

Kompania e ndërtimit, për fazën B, ka larguar në formën e duhur materialet ndërtimore në një venddepozitim të aprovuar nga pushteti vendor në përputhje me legjislacionin kryesor përkatës. TIA ka ndërmarrë masa të tjera për të përmirësuar teknikën e menaxhimit të mbetjeve të tilla si: makina automatike pastrimi, kamionçinë e re për shërbimin e pastrimit, etj. Zbatimi i projektit për vendgrumbullimin e mbetjeve urbane, të riciklueshme dhe të rrezikshme si dhe zbatimi me efektivitet i programit për riciklimin e mbetjeve, udhëzimet përkatëse dhe trajnimi i punonjësve të TIA-s dhe stafit të mirëmbajtjes në menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të menaxhimit të mbetjeve dhe infrastrukturës në Aeroport.

Monitorimi i zhurmave

Në dekadat e fundit, është shënuar një rritje e konsiderueshme e numrit të lëvizjeve të trafikut ajror në botë, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Nga vetë natyra e tij, transporti ajror lidh vende të ndryshme me njëri-tjetrin dhe si rrjedhojë, ajo çka ndodh në një vend ndodh edhe në vendet e tjera. Në këtë mënyrë në Shqipëri janë paraqitur modele të reja motorësh avioni që ndihmojnë të përballojnë sfidat ndaj mjedisit si shkak i operimeve të avionëve. Përkundëjt këtyre kushteve të paraqitura, veçanërisht ndaj rritjes së shpejtë të numrit të fluturimeve në vend, ndotja nga zhurmat sa vjen e bëhet një çështje shumë e rëndësishme në vendin tonë.

Për të siguruar të dhëna mbi ndotjen nga zhurmat në afërsi të aeroportit, TIA monitoroi nivelin e zhurmave në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës për të tretin vit radhazi. Qëllimi i programit të matjeve të nivelit të zhurmave ka si synim të krahasojë dhe llogarisë nivelet mesatare të zhurmave gjatë orëve të ditës dhe natës, në zonën përreth aeroportit. Matjet e nivelit të zhurmave përmbajnë regjistrimin e të gjithë ngjarjeve në një vendodhje dhe ato janë ndarë në kontribues të zhurmave si shkak i avionëve dhe burimeve të tjera.

Ky program siguron përshkrimin e procesit të matjes, përshkrimin e vendndodhjeve të zgjedhura për matjen e zhurmave dhe analizën sasiore të rezultateve të matjeve ndaj zhurmave. Vendndodhjet janë zgjedhur në mënyrë të tillë që të mundësohet vlerësimi për nivelin e zhurmës në mjedis të ndryshme duke përfshirë vendndodhje si brenda zonës së aeroportit ashtu edhe në shtëpitë e banorëve afër zonës ajrore.



procedures with regard to the introduction of noise related operating restrictions at community airport"

The measurements were conducted during both, peak and non-peak seasons, specifically during July and November 2009. Measurements were conducted at fourteen sites within or outside the Airport area, including the passenger terminal and administration building. Measurements were made over 24 hours and split into three periods: day (07.00-19.00 hrs), evening (19.00-23.00 hrs) and night (23.00-07.00 hrs).

During this period special attention was paid to monitoring noise levels generated during construction activities in order to avoid interference and implications with daily operations. In this regard the Construction Monitoring Program for Environmental Protection was implemented properly and specific measures were taken such as rescheduling of activities of the construction company during periods of the day that resulted in least disturbance.

Important results from the measurement program for 2009 include the following:

- Inside terminal building
From the measurements carried out in the Arrival area and Departure area no sources of maximum noise inside the passenger terminal were related directly to aircraft.
- Outside and close to terminal building
Average noise emissions from cars, buses, baggage carts, taxiing aircraft and the temporary process of reconstruction on the apron were calculated at 68.0 dB(A) during the day, 63.9 dB(A) during the evening and 65.1 dB(A) during the night.

The results were found to be within the limits set by national and international regulations listed above.

Air quality management

In compliance with the Albanian environmental legislation and TIA's environmental permit, the TIA carried out an air quality monitoring program to check for atmospheric pollutants. This program is undertaken in order to protect the health of the public and employees and to permanently maintain high air quality at the Airport.

Programi i matjeve është në përputhje me lejen mjedisore të kompanisë dhe legjislacionin kombëtar dhe evropian:

- Ligji Nr. 9774 më datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmave në mjedis"
- VKM Nr. 103 më datë 31.3.2002 "Për monitorimin e mjedisit"
- Udhëzimi Nr. 8 më datë 27.11.2007 "Për nivelet kufij të zhurmave në mjedis të caktuara"
- Direktiva 2002/30/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit të BE-së e datës 26 Mars 2002 për vendosjen e rregullave dhe procedurave në lidhje me përhapjen dhe kufizimin e zhurmave në afërsi të Aeroportit.

Matjet u kryen gjatë sezonit të pikut dhe jashtë tij, kryesisht gjatë muajve korrik dhe nëntor të vitit 2009. Matjet u kryen në 14 pika brenda/jashtë zonës së Aeroportit, në terminalin e pasagjerëve dhe ndërtesën e administratës. Matjet 24-orëshe u klasifikuan në tre periudha: orët e ditës (07.00-19.00), orët e mbrëmjes (19.00-23.00) dhe orët e natës (23.00-07.00).

Gjatë kësaj periudhe një vëmendje të veçantë iu kushtua monitorimit të nivelit të zhurmave të prodhuar gjatë aktivitetit të ndërtimit në mënyrë që të shmangeshin ndërhyrjet dhe ndërlikimet me operimet e ditës. Në këtë drejtim, Programi i Monitorimit të Ndërtimeve për Mbrojtjen e Mjedisit u zbatua siç duhet dhe u morën masa të tilla si planifikimi i veprimtarive të kompanisë së ndërtimit gjatë periudhave të ditës që rezultuan me më pak shqetësim.

Rezultatet e rëndësishme nga programi i matjeve të vitit 2009 janë si më poshtë:

- Brenda godinës së terminalit të ri
Nga matjet të cilat u kryen në zonën e Mbrojtjes dhe Nisjes, asnjë burim i nivelit maksimum të zhurmave brenda ndërtesës së terminalit nuk lidhet në mënyrë direkte me avionët.
- Matjet e zhurmave të jashtme dhe afër godinës së terminalit
Shkarkimet mesatare të zhurmave nga makinat, autobusat, karrocet e bagazheve, taksitë, dhe procesi i përkohshëm i rikonstruksionit të rampës u llogarit me një nivel zhurme 68dB(A) gjatë orëve të ditës, 69.3 dB (A) gjatë orëve të mbrëmjes dhe 65.1 dB(A) gjatë orëve të natës.

Rezultatet nga matjet e kryera për nivelin e zhurmave ishin brenda kufijve të lejuar referuar rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të listuara më sipër.

Menaxhimi i cilësisë së ajrit




Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe lejen mjedisore të TIA-s, kompania ka zbatuar programin monitorues të cilësisë së ajrit për kontrollin e ndotësve atmosferikë. Ky program është ndërmarrë për të mbrojtur shëndetin publik dhe atë të punonjësve të TIA-s si dhe për të ruajtur gjithmonë cilësi të lartë ajri në aeroport.

National and international legislation concerning monitoring of air pollution includes the following:

- Law No. 8897, dated 16.5.2002 "On Protection of Air from Pollution"
- DCM No. 803, dated 4.12.2003 "On the Norms of Air Quality"
- DCM No. 103, dated 31.3.2002 "On Environmental Monitoring"
- EU Air Quality Framework Directive
- WHO guideline

Methodology

In compliance with air quality regulations and environmental procedures TIA monitors air quality at and near the Airport in order to detect any atmospheric pollutants that might need remedial action and minimize any environmental and health impacts due to airport activity in the concession area and vicinity. Sampling and analysis are carried out by external experts. The monitoring was carried out during the peak season, in July, and also in the off-peak season, in November, in both indoor and outdoor environments of the Airport.



Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me monitorimin e ndotjes së ajrit:

- Ligji nr. 8897 më datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga Ndotja"
- VKM nr. 803 më datë 04.12.2003 "Për normat e Cilësisë së Ajrit"
- VKM nr. 103 më datë 31.03.2002 "Për Monitorimin e Mjedisit"
- Direktiva kuadër e BE-së për Cilësinë e Ajrit
- Udhëzimet e OBSH-së (Organizata Botërore e Shëndetësisë)

Metodologjia

Në përputhje me rregulloret e cilësisë së ajrit dhe procedurat mjedisore, TIA monitoron cilësinë e ajrit me qëllim identifikimin e ndonjë ndotësi atmosferik që mund të ketë nevojë për veprim korrigjues dhe minimizim të ndikimit në mjedis dhe shëndet për shkak të aktiviteteve të Aeroportit në zonën e koncesionit dhe në afërsi të saj. Marrja e mostrave dhe analiza e tyre u kryen nga ekspertë të jashtëm.

Monitorimi u krye në mjediset e jashtme dhe të brendshme të aeroportit, gjatë sezonit të pikut të lëvizjeve të trafikut ajror në muajin korrik dhe gjithashtu në nëntor jashtë sezonit të pikut. Ndotësit kryesorë të rregjistruar dhe monitoruar nga ky proces janë PM₁₀ (grimcat e pluhurit), SO₂ (dioksid sulfuri), CO (monoksid karboni) O₃ (ozoni), NO₂ (dioksid azot). Për tetë ditë të njëpasnjëshme, 24 orë për secilën nga këto ditë, u kryen matjet për treguesit e cilësisë së ajrit brenda dhe jashtë mjedisve të aeroportit.

Pozicionet e monitorimit

1. Mjedis i jashtëm Shërbimi i Ndricimit të Aeroportit (AFL)
2. Mjedis i brendshëm Zyra e Financës (AO)
3. Mjedis i jashtëm Departamenti i Mjedisit (ED)
4. Mjedis i brendshëm Terminal (TB)

Rezultatet

Duket qartë nga rezultatet se parametrat janë në mënyrë të konsiderueshme më të ulët se limitet e parashikuara nga standardet shqiptare dhe ato të BE-së. Nuk ka pasur dallime të rëndësishme midis këtyre rezultateve dhe atyre të marra nga monitorimi i mëparshëm i realizuar në qershor 2008, të paraqitur në Buletin e Tretë Mjedisor dhe Social.

Monitorimi i cilësisë së ajrit do të vazhdojë të kryhet gjatë sezonit të pikut dhe jashtë tij.

Mjedis natyror

Zogjtë dhe menaxhimi i organizmave të dëmshëm TIA sipas procedurave të saj kryen kontrollin mbi veprimtarinë e zogjve dhe popullatave të kafshëve të tjera për të reduktuar aktivitetin e kafshëve të egra të cilat mund të përbëjnë një rrezik për përplasje me avionin. Një monitorim konstant kryhet për praninë e zogjve në zonën ajrore dhe është ngritur një sistem i ri për të frikësuar zogjtë nëpërmjet instalimit të një pajisjeje zanore si dhe ka një sistem monitorimi për praninë e bregtësve në zonën ajrore.

The main pollutants monitored and recorded were PM₁₀, SO₂, CO, Ozone (O₃), NO₂. For eight consecutive days, and for 24 hours a day, levels of these pollutants were measured in indoor and outdoor locations.

Monitoring sites

1. Outdoor Aerodrome Field Lighting (AFL) building
2. Indoor Accounting Office (AO)
3. Outdoor Environment Department (ED)
4. Indoor Terminal (TB)

Results

It is clear that the measurements are considerably lower than both the national and EU limits. There were no significant differences between these results and those obtained from the previous monitoring (reported in the Third Environmental & Social Bulletin).

Air quality monitoring will continue to be conducted during both, peak and non-peak seasons.

Natural Environment

Bird and Pest Management

TIA, according to its procedures, undertakes control of bird and other animal populations in order to reduce wildlife activities that can pose a risk of collision with aircraft. Constant monitoring takes place for the presence of birds on the airfield, and a new bird scaring system has been introduced with the installation of an audio system and a monitoring system for the presence of rats airside.



Landscaping and gardening

Proper development and maintenance of landscaping and gardening at TIA are performed in compliance with the respective legal requirements and international standards. An external specialist contractor is responsible for landscaping and gardening (planting, maintenance and monitoring) at the Airport following TIA's Standard Operating Procedures and other general policies and procedures.

During the construction phase there were only small interferences with the existing landscaping. Upon removal of the construction site all the area concerned was remediated, a new green area planted and the irrigation system extended.

Wildlife Habitat Mitigation Study

Within the framework of the implementation of its EHSSAP regarding the Wildlife Habitat Program, TIA has been conducting a Wildlife Habitat Mitigation Study, the aim of which is to build an inventory of flora and fauna near the Airport. This will facilitate the analysis of any impact of airport activities on wildlife in accordance with both Albanian and international legislation and identify actions and measures to mitigate negative impacts.



Peisazhi dhe kopshtaria

Përmirësimi dhe mirëmbajtja e peisazhit, kopshtarisë së Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës janë kryer në përputhje me kërkesat respektive ligjore dhe standardet ndërkombëtare. Një kontraktor i jashtëm i specializuar është përgjegjës për peisazhin dhe aktivitetet e kopshtarisë (mbjelljen, mirëmbajtjen, monitorimin) në aeroport në ndjekje të Procedurave Standarde Operative si dhe politikave dhe procedurave të tjera.

Gjatë fazës B të ndërtimit u vunë re disa ndërhyrje të vogla ndaj peisazhit ekzistues. Me mbarimin e fazës ndërtimore, e gjithë zona e përfshirë nga ndërtimet dhe materialet ndërtimore, u kthye në një zonë të mbjellë e me gjelbërim duke zgjeruar gjithashtu edhe sistemin e ujitjes.

Studimi i florës dhe faunës

Përsa i përket programit mbi florën dhe faunën, TIA ka kryer një studim të habitateve të botës së gjallë, qëllimi i të cilit është krijimi i rekordeve për florën dhe faunën pranë zonës së aeroportit. Ky studim do të lehtësojë analizën përpara i përket ndikimit të aktiviteteve të aeroportit mbi botën e gjallë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar si dhe do bëjë të mundur identifikimin e veprimeve dhe masave për të zbutur ndikimet negative.

Safety Management & Emergency preparedness and response

Menaxhimi i sigurisë dhe gatishmërisë në rastet e emergjencave

TIA has addressed the issue of operational safety as a top priority. All personnel are aware of their individual involvement, role and responsibilities in the event of an accident and in any environmental impact. Relevant procedures and training have helped achieve this target. TIA's Airport Emergency Plan provides guidelines on how to react in the case of an accident or emergency.



For each significant activity, appropriate controls are in place to maximize a quality and environment-oriented performance. All procedures are systematically analyzed and checks concerning possible emergency situations that might result in deleterious environmental effects are put in place while systems, procedures and training are implemented to minimize any such impact.

Specific measures undertaken by TIA to cope with emergency situations include:

- infrastructure upgrade and equipment for Rescue and Fire Fighting Station, including a training classroom and gym room
- upgrade of safety airside infrastructure, improving lighting, marking, signage, foreign object damage (FOD) system
- refurbishment of emergency room, complete with all essential equipment
- training of staff in dealing with emergencies: specifically emergency planning and crisis management
- establishment of a TIA Care Team consisting of 26 employees
- introduction to Emergency Planning and Crisis Management Training for the TIA Care Team
- visit by TIA representatives, TIA Rescue and Fire Fighting Director and Director of National Emergencies to Dusseldorf Airport (Emergency Department and RFFS)
- full-scale emergency exercise



Si prioritet kryesor i TIA-s qëndron çështja mbi sigurinë gjatë operimeve. I gjithë personeli është i ndërgjegjshëm për përfshirjen individuale, rolin dhe përgjegjësitë në çdo rast aksidenti apo impakti mjedisor. Procedurat si dhe trajnimet lidhur me çështjet e sipërpërmendura kanë ndihmuar në arritjen e këtij objekti. Plani i Emergjencës së aeroportit të TIA-s siguron udhëzimet e duhura për çdo formë reagimi në rast aksidenti apo emergjence.

Për çdo aktivitet të rëndësishëm ndërmerren kontrollet e duhura për të rritur në maksimum cilësinë dhe performancën. Të gjitha procedurat analizohen në mënyrë sistematike dhe kryhen kontrolle periodike në lidhje me situata emergjente të mundshme që mund të kenë efekte negative në mjedis, ndërsa sistemet, procedurat dhe trajnimet janë implementuar me qëllim minimizimin e impaktit që mund të shkaktohet në këto raste. Kontrolle të këtij lloji përfshihen si në procedurat e kontrollit operacional ashtu edhe atë fizik dhe mbulohen nga personel i trajnuar dhe kompetent.

TIA ka ndërmarrë masa specifike për t'u përballur me situata emergjente, të cilat përfshijnë:

- rinovimin e Stacionit të Zjarrfikëseve, duke përfshirë edhe një palestër
- përmirësimin e infrastrukturës për sigurinë në zonën ajrore, që përfshin përmirësimin e ndriçimit, sinjalistikës, shenjave dhe vijëzimit të rrugëve të shërbimit, rrugëve lidhëse, rampës dhe pistës si dhe sistemit të Objekteve të Huaja (FOD) në zonën ajrore
- pajisjen dhe kompletimin me të gjitha pajisjet e nevojshme të dhomës së emergjencave
- trajnimin e stafit në lidhje me emergjencat: veçanërisht lidhur me planin e emergjencave si dhe me menaxhimin e krizave
- formimin e ekipit të TIA-s për Kujdesin e përbërë nga 26 punonjës
- trajnimin për Planin e Emergjencave dhe për menaxhimin e krizave për Ekipin e TIA-s për Kujdesin
- vizita të përfaqësuesve të TIA-s, Drejtorit të Zjarrfikëseve dhe Drejtorit të Emergjencave Kombëtare në Aeroportin e Dusseldorfit (Departamentin e Emergjencave dhe Shërbimit të Zjarrfikëseve)
- test në shkallë të gjerë për emergjencat

Më 1 prill 2009 u testuan, përmes një alarmi fals emergjence, strukturat përgjegjëse të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, konkretisht Departamenti i Shërbimeve të Zjarrfikëseve, Njësia e Ndihmës së Shpejtë dhe stafi i TIA-s. U simulua një përplasje midis një avioni dhe një makine të shërbimit aeroportual në zonën e parkimit të avioneve në aeroport. Testimi në shkallë të gjerë për emergjencat vuri në gjatë strukturat e shërbimeve aeroportuale të sipërpërmendura nën procedura rigorozë, dhe të gjitha njësitë treguan një performancë të shkëlqyer. Rreth 100 vullnetarë u përfshinë gjatë ushtrimit të testimit bashkë me

The response levels of the Rescue and Fire Fighting Department, the First Aid Unit and other staff were tested with a false emergency alarm on Wednesday 1 April 2009. A crash was simulated between an aircraft and an airport service vehicle on the Airport apron. The full-scale emergency exercise put the above Airport services through stringent procedures, and in response all units performed excellently. Some one hundred volunteers also participated in the exercise along with members of Albania's civil emergency bodies, including the General Directorate of Civil Emergencies, the Ministry of Interior (with its airport police task force), Ministry of Defence (its airport military structures) and Ministry of Health. The Red Cross also took part in the exercise. The exercise was diligently observed by representatives of TIA, the involved State Entities including the Deputy Minister of Interior, Mr. Ferdinand Pone.

The requirement to perform such exercises enables TIA to demonstrate that, in the unlikely event of an emergency, all of its units can and do react promptly and appropriately, that immediate safety measures are taken and prompt recovery is ensured, all of which depend on the existing level of preparedness.

Officials from Albania's Civil Aviation Authority, local authorities, Police Assistance Mission of the European Community to Albania (PAMECA) and Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE) were present at the exercise.

TIA successfully tested its new extended terminal on 20 August 2009, ahead of the opening ceremony that took place on 9 September. The test aimed at ensuring the operational readiness of the new facilities and equipment ahead of the official opening. All systems were tested successfully, giving TIA the opportunity to demonstrate standard modern airport operations, to test the new facility's systems and processes and the preparedness of the staff. The tests were designed to assist the Airport management team detect any shortcomings and take corrective actions, and ensure smooth operations at the new facility from day one. This flight operations test was not only a key factor to determine if the terminal extension was ready for operations, but also an essential procedure upon which was based the decision to begin operations at the extended terminal just three weeks later.

Passengers flying with British Airways to London Gatwick were the first to use the extended terminal, which includes thirteen new check-in counters, three new gates, one bar, five shops and a bank. Check-in for flight BA 2649 opened at 18:00 hrs and continued until the last passenger went to the new gate to catch the flight to London.

Continuous cooperation of TIA with the Ministry of Health, Institute of Public Health, Directorate of Public Health and Sanitary Inspectorate, General Directorate of Civil Aviation and airlines to manage the emergency situation of A H1N1 (swine flu virus) was and continues to be provided. Information boards, staff and first aid equipment were made available in the Arrivals area of the passenger terminal.

anëtarë të strukturave shtetërore të emergjencës civile, duke përfshirë këtu Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrinë e Brendshme (me policinë e aeroportit), Ministrinë e Mbrojtjes (me strukturat e saj ushtarake në aeroport) si dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Kryqi i Kuq ishte gjithashtu i përfshirë gjatë testimit. Ky ushtrim u vëzhgua me kujdes nga përfaqësues të TIA-s, përfaqësues të shtetit, duke përfshirë Zëvendësministrin e Ministrisë së Brendshme, Z. Ferdinand Pone.

Kërkesa për të kryer teste të këtij lloji i jep mundësinë TIA-s të ketë sigurinë se në raste të ngjashme emergjence, të gjitha strukturat e aeroportit mund dhe do të reagojnë në formën e duhur dhe në një kohë sa më të shkurtër, duke mundësuar gjithashtu dhe marrjen e masave të sigurisë dhe mbulimin e situatave të tilla emergjence në të ardhmen, të cilat varen nga niveli aktual i gatishmërisë.

Të pranishëm gjatë testimit ishin gjithashtu edhe zyrtarë nga Autoritetet e Aviacionit Civil, pushtetit lokal, Misionit të Asistencës Policore të Bashkimit Evropian në Shqipëri (PAMECA), dhe nga Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit Evropian në Shqipëri (OSCE).



TIA testoi me sukses zgjerimin e terminalit të ri më 20 gusht 2009, përpara ceremonisë zyrtare të hapjes që u zhvillua më 9 shtator. Testi kishte për qëllim të sigurote gatishmërinë operacionale të shërbimeve dhe aparaturave të reja para hapjes zyrtare. Të gjitha sistemet e testuara rezultuan me sukses, duke i dhënë TIA-s mundësinë për të treguar standardet moderne të operimit të aeroportit, me testimin e sistemeve dhe proceseve të reja, dhe përgatitjes së stafit për këtë zgjerim. Testet ishin paracaktuar për asistimin e ekipit të menaxhimit të aeroportit, për identifikimin e ndonjë mangësie të mundshme dhe ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese, si dhe për sigurimin e faciliteteve të reja për operacionet nga testimi e më tej. Kjo provë për operimet nuk përcaktonte një faktor kyç vetëm për gatishmërinë e operimit pas zgjerimit, por mbi të gjitha është një procedurë thelbësore mbi të cilën u bazua dhe vendimi për nisjen e operimeve në terminalin e zgjeruar tre javë me vonë.

Pasagjerët të cilët do të udhëtonin për në Londër Gatwick me kompaninë ajrore British Airways ishin të parët që shfrytëzuan shërbimet e reja të terminalit të zgjeruar, i cili përfshin trembëdhjetë sportele të reja pritjeje, tre porta të reja për daljen e pasagjerëve, një bar, pesë dyqane dhe një bankë. Pranimi i pasagjerëve



Health and Safety

TIA staff

Training in safety, proper use of personal protective equipment (PPE) and handling dangerous goods and hazardous materials are regularly organized for TIA's staff.

Construction Site

TIA's QEHS and Construction Departments organized periodical site inspections and observations at the construction site to check compliance with legislation and to ensure proper implementation of the EHS Action Plan and Construction Monitoring Program for Environmental Protection signed by TIA and the construction companies. The QEHS Department organized meetings and training in safety awareness for TIA staff and prepared a Site Inspection Form on Environment Health and Safety to be used and recorded by the Construction Department during their routine inspections.

During construction around 120 employees were involved in the terminal extension works. Workers were equipped with and used PPE (helmets, gloves, safety shoes, belts, etc.). Safety and warning signs were installed in both Albanian and English. At the site several bins were provided and raw materials properly stored, preventing the possibility of foreign object damage or interference with the airside area.

Site inspections and observations at construction sites show that the construction works were performed in compliance with all environmental, health and safety requirements.

Accidents

Working conditions and health and safety of TIA employees and contractors staff, have been an area of particular importance for TIA.

The number of accidents concerning TIA staff, the construction contractor, maintenance contractor and other TIA contractors was nil, except a work injury happened with an employee of contracted construction company.

për fluturimin BA 2649 filloi në orën 18:00 dhe vazhdoi derisa pasagjeri i fundit kaloi tek portat e reja për t'u imbarkuar në avionin drejt Londrës.

Menaxhimi për situatën emergjente ndaj virusit A H1N1 (virusi i gripit të derrave) vazhdon të funksionojë në bashkëpunim të vazhdueshëm midis TIA-s dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Shëndetit Publik, Drejtorisë së Shëndetit Publik dhe Inspektoriatit Sanitar, Autoriteteve të Aviacionit Civil si dhe linjave ajrore. Bordet e informacionit, stafi dhe pajisjet e ndihmës së shpejtë janë në dispozicion në zonën e mbërritjes në terminal.

Shëndeti dhe siguria

Stafi i TIA-s

Trajnimet për sigurinë, përdorimin e duhur të pajisjeve personale mbrojtëse dhe shërbimet në lidhje me transportin e mallrave dhe materialeve të rrezikshme organizohen rregullisht nga stafi i TIA-s.

Zona e ndërtimit

Departamenti i QEHS në TIA dhe Departamenti i Ndërtimit kanë kryer inspektime periodike dhe kanë vëzhguar gjatë fazës së ndërtimit për të kontrolluar përputhshmërinë e ndërtimit me legjislacionin dhe për të siguruar implementimin në formën e duhur të Planit të Veprimit për Mjedisin, Shëndetin, Sigurinë dhe Social si dhe të Programit për Monitorimin e Ndërtimit për Mbrojtjen e Mjedisit, nënshkruar nga TIA dhe kompania e ndërtimit. Departamenti i QEHS ka organizuar takime të ndryshme dhe trajnime ndërgjegjësuese për rëndësinë e sigurisë për stafin e TIA-s dhe ka përgatitur një formë inspektimi në terren për çështjet e Shëndetit, Mjedisit dhe Sigurisë për t'u përdorur dhe për të mbajtur rekorde gjatë inspektimeve rutinë nga Departamenti i Ndërtimit.

Gjatë fazës së ndërtimit për zgjerimin e terminalit janë përfshirë rreth 120 punonjës. Punëtorët ishin të pajisur dhe përdornin Pajisjet Personale Mbrojtëse, si doreza, këpuce sigurie, rripa etj. Shenjat e sigurisë dhe ato paralajmëruese u instaluan si në gjuhën shqipe edhe në atë angleze. Në zonën e ndërtimit u mundësua ruajtja e materialeve të ndërtimit në një formë sa më të përshtatshme për të parandaluar Mbetjet e Objekteve të Huaja (FOD) dhe për të mos penguar operimin në zonën ajrore.

Inspektimet në terren dhe observimet në zonën e ndërtimit tregojnë se puna ndërtimore është kryer në përputhje me të gjitha kërkesat mjedisore, shëndetit dhe sigurisë.

Aksidentet

Kushtet e punës si dhe shëndetit dhe sigurisë për punonjësit e TIA-s dhe për stafin e kontraktorëve, përbëjnë objekt të një rëndësie të veçantë për TIA-n. Numri i aksidenteve në lidhje me stafin e TIA-s, stafin e kompanisë së kontraktuar për ndërtimet, stafin e kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen dhe të kontraktorëve të tjerë me TIA-n është zero, me përjashtim të një dëmtimi në punë të një punonjësi të kompanisë së ndërtimit.

Airport expansion & sustainable construction

Zgjerimi i aeroportit dhe aktiviteti i ndërtimit sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm

The Airport expansion included the extension of the Passenger Terminal and other projects focused on supporting Airport operations such as enhancing the Rescue and Fire Fighting station (Equipment on Airside Area and installation of Station), preparing for relocation of the fuel farm, apron extension and airfield investments, as well as the installation of additional equipment and systems.

The extension of the state-of-the-art terminal, through an investment of more than EUR 20 million on top of the original investment in the terminal, provides a capacity of 1.5-1.8 million passengers per year. Following a combined construction period that lasted nearly two years the new terminal is now fully operational. It opened as scheduled.

The extension adds a further 3,943 square meters to the terminal, which now has a height of façade ranging from 7 to 13.5 meters. The new baggage handling facilities cover 890 square meters, giving a total size of expansion of 4,833 square meters. The overall volume of the building is 40,000 cubic meters, and it now houses extended business lounge premises of 300 square meters, more than double the 130 square meters of the previous facility.

The construction team comprised workers from various countries: the construction itself was undertaken according to British Standards by Albanian contractors Trema Engineering 2 SHPK, and design review and construction supervision by German company DIWI Consult International GmbH, following the original architecture of Malaysian Hin Tan.

This architectural masterpiece houses new check-in counters, new gates, new shops, a bar, new bank and new exchange unit. The new terminal satisfies the most sophisticated of requirements and makes a major contribution to the urban transformation of Tirana.

Since April 2005, the Airport has been operated by the private company Tirana International Airport SHPK (formerly Tirana Airport Partners) whose shareholders are HOCHTIEF AirPort, DEG Deutsche Investitions und Entwicklungsgesellschaft and the Albanian-American Enterprise Fund. The financing of the EUR 70 million investment program (Phase A plus Phase B) was arranged with the European Bank for Reconstruction and Development (EBRD) as principal lender supported by Intesa Sanpaolo Bank, Alpha Bank and DEG.

Prior to commencement of the construction works, an Environment Analysis and Audit was carried out by TIA's QEHS Department to identify potential environmental and health impacts of the development and the measures to be taken to mitigate any impacts. The conclusions of the report were that the project would not cause any significant environmental and

Zgjerimi i Aeroportit përfshin shtimin e terminalit të pasagjerëve dhe planifikime të tjera të fokusuara në mbështetjen e operimeve në aeroport të tilla si zmadhimin e mjedisit të Shërbimit të Zjarrfikëses, vendosjen e aparaturave në zonën e ajrore duke planifikuar dhe zhvendosjen e pikës së karburantit, zgjerimin e vendqëndrimit të avionëve, dhe investimeve të tjera në zonën ajrore, si dhe instalimin e sistemeve dhe pajisjeve plotësuese.



Kjo kryevepër arkitekture e zgjerimit të terminalit, nëpërmjet një investimi prej 20 milionë Euro mbi investimin kryesor të ndërtimit të terminalit, ofron një kapacitet shërbimi prej 1.5 - 1.8 milionë pasagjerësh në vit. Pas një periudhe dy-vjeçare punimesh, terminali është plotësisht funksional. Terminali filloi punën sipas afateve të përcaktuara.

Zgjerimi i terminalit shtoi një sipërfaqe prej 3,943 m², i cili tashmë ka një lartësi fasade e cila varion nga 7 - 13.5 m e lartë. Pajisjet e transportit të bagazheve mbulojnë një sipërfaqe prej 890 m² me një sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 4,833 m². Vëllimi i objektit është 40,000 m³, këtu përfshihet dhe një sallë biznesi e cila ka një sipërfaqe ndërtimi 300 m², më shumë se dyfishi i sipërfaqes së objektit të mëparshëm prej 130 m².

Skuadra e ndërtimit përfshiu punonjës nga vende të ndryshme: të gjitha projektet janë zbatuar nga kontraktori shqiptar Trema Engineering 2 SHPK në përputhje me standardet britanike, ndërsa kompania gjermane DIWI Consult International GmbH ka supervizuar punimet dhe ka inspektuar konstruksionin sipas arkitekturës origjinale të malajzianit Hin Tan.

Kjo vepër e re arkitektonike ka sportele të reja pritjeje, porta të reja, dyqane të reja, një lokal, bankë të re, dhe një pikë të re këmbimi valutator. Terminali i ri përmbush edhe kërkesat më të sofistikuar dhe përbën një kontribut mjaft të shquar në transformimin urban të Tiranës.



social impacts. We can safely state that all of the works were carried out in a sustainable way and implemented satisfactorily according to Environmental, Health and Safety and Social Action Plan (EHSSAP).

In general, all operations at TIA are in compliance with the relevant national and EU environmental, social, and health and safety requirements.

Që nga muaji prill 2005, TIA është drejtuar nga kompania private Tirana International Airport SHPK (ish Tirana Airport Partners) aksionerët e së cilës janë HOCHTIEF AirPort (HTA), DEG Deutsche Investitions und Entwicklungsgesellschaft dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan (AAEF). Financimi i investimit prej 70 milionë eurosh në total, (Faza A dhe Faza B) është bërë i mundur nga EBRD (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) si huadhënës kryesor, dhe i mbështetur nga Intesa Sanpaolo Bank, Alpha Bank dhe DEG.

Para fillimit të punimeve të ndërtimit, nga Departamenti i Cilësisë së Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë në TIA, u krye një Analizë Mjedisore dhe Kontrolli për të identifikuar ndikimet potenciale mjedisore dhe shëndetësore të zhvillimit dhe masat që duhen ndërmarrë për të zbutur çdo ndikim. Konkluzionet e raportit ishin se projekti nuk do të shkaktojë ndonjë ndikim të konsiderueshëm mjedisor dhe social. Ne mund të konfirmojmë me siguri se të gjitha punimet u kryen sipas parimeve të zhvillimit të qendrueshëm dhe u zbatuan në mënyrë të kënaqshme në përputhje me Planin të veprimit për Mjedisin, Shëndetin, Sigurinë dhe Social (PVMSSH).

Në përgjithësi të gjitha operimet e kryera në TIA janë në përputhje me kërkesat mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë, në kuadër të legjislacionit kombëtar dhe të BE-së.

Customers

Meeting the highest levels of quality of service, safety, security and comfort is one of TIA's main commitments. Provision of a high level of satisfaction for passengers, airlines and other users and continuous satisfaction of Airport customers constitutes a challenge for the Company to ensure a consistent and reliable level of performance standards in order to meet the customer's needs and expectations. Continuous measurements are undertaken by TIA to identify carefully the customers' level of satisfaction.

Terminal extension improves Customer Service

In order to increase the level of customer satisfaction and meet their demands, the newly extended terminal provides passengers with new handling facilities including an increased check-in area, additional gates and waiting area and a new smoking area. Furthermore the new commercial offer includes a new bar, a bank, a new exchange unit and new shops amongst which a souvenir shop promoting Albanian culture to all visitors of the Airport.



Një ndër angazhimet kryesore të TIA-s është përmbushja e standardeve të larta ndërkombëtare, ofrimi i shërbimeve në një klimë sa më të sigurt dhe cilësore për të gjithë klientët në një mjedis të sigurt dhe komfort. Përmbushja në një shkallë sa më të gjerë e kërkesave të pasagjerëve, linjave ajrore dhe përdoruesve të tjerë të aeroportit si dhe kënaqësia e vazhdueshme e klientëve të aeroportit përbën një sfidë për TIA-n në mënyrë që të sigurojë një nivel të qëndrueshëm dhe sa më cilësor të standardeve të performancës me qëllim plotësimin e nevojave dhe kërkesave të klientëve. Monitorime të vazhdueshme janë zhvilluar nga TIA duke pasur si synim identifikimin e nivelit të kënaqësisë së klientëve për shërbimet e ofruara.

Përmirësimi i shërbimeve ndaj klientëve me zgjerimin e terminalit

Për të rritur nivelin e kënaqësisë së klientit dhe për të plotësuar kërkesat e tyre, me zgjerimin e terminalit të ri, pasagjerët gëzojnë shërbime të reja që përfshijnë: zgjerimin e zonës së check-in për kryerjen e shërbimeve aeroportuale, shtesën e portave dhe mjedisve të pritjes si dhe mjedis të ri ku lejohet pirja e duhanit. Veç kësaj, në aspektin komercial, ofrohet një lokal i ri, një bankë, një pikë e re për këmbimin valutor dhe dyqane të reja, midis të cilave një dyqan dhuratash që promovon kulturën shqiptare tek të gjithë vizitorët e aeroportit.

Klientët

With the addition of these new services, TIA is promoting its policy of continuously improving services offered to all customers and providing variety and top quality service, ensuring that the level of customer satisfaction will be maintained.

Tourist Information Point

A Tourist Information Point was set up in the terminal in February 2009 in order to provide a wide range of tourism information for passengers. The purpose of this well thought out initiative is to improve the quality and range of services offered to TIA's passengers and to support the development of tourism in Albania as a significant branch of the country's economy. The Information Point was set up as part of TIA's strategy to promote good business sense by continuously improving the environment inside the Airport in order to raise customer satisfaction, fulfilling their needs and expectations.

Information boards

Two boards have been installed providing information on TIA and on Passenger Rights (in both English and Albanian). They can be seen at the Information Desk and in the Transit Area.

Cargo

Personalized options for shipping of goods requiring special care, goods of value, live animals and hazardous materials is provided to TIA customers through Turkish Airlines Cargo aircraft. This new freight-only service is intended to stimulate local business development and marks an important achievement in the Airport's history.

The Chief Operation Officer, Mr. Rolf Castro-Vasquez noted that expanding the fleet at TIA with the Airbus 310-300 would allow TIA to further meet Albania's demand for air cargo transportation and help develop local business. The cargo carrier was an ideal complement to TIA's aircraft portfolio and builds upon its success with respect to air freight. The Airbus's payload and range characteristics have opened up new possibilities for airport customers coupled with very attractive operating costs.



Me këto shërbime të ofruara shtesë TIA jo vetëm promovon por dhe nxit politikën e përmirësimit të këtyre shërbimeve për të gjithë klientët si dhe siguron larminë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara në mënyrë që niveli i kënaqësisë së klientit të vazhdojë të mbahet në të ardhmen.

Zyra e Informacionit Turistik

Një Zyrë për Informacion Turistik është ngritur brenda ambjenteve të terminalit në shkurt të 2009 me iniciativën e TIA-s duke u ofruar pasagjerëve informacion të bollshëm për të përmbushur më së miri interesat e tyre, apo për të shuar kuriozitetin për Shqipërinë. Qëllimi i kësaj iniciative kaq të rëndësishme është në radhë të parë për përmirësimin e cilësisë dhe llojshmërisë së shërbimeve që u ofrohet pasagjerëve, por gjithashtu dhe për mbështetjen e zhvillimit të turizmit, i cili përbën një sektor mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Zyra e Informacionit Turistik është pjesë e strategjisë së TIA-s për të promovuar frymën e mirë të bashkëpunimit në fushën e biznesit në sajë të punës për përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisve në aeroport me qëllim rritjen e nivelit të kënaqësisë së klientit dhe përpjekjes për të kuptuar dhe për t'u paraprirë nevojave të tyre.

Stendat e informacionit

Në terminal janë vendosur dy stenda të cilat ofrojnë informacionin e duhur mbi TIA-n dhe Të Drejtat e Pasagjerit (si në gjuhën angleze ashtu edhe në shqip). Këto stenda gjenden pranë qendrës të informacionit në zonën e nisjeve, dhe në zonën e tranzitit.

Transporti i mallrave

Klientëve të TIA-s u është siguruar mundësia për transport të mallrave që kërkojnë një kujdes të veçantë në transportim, të mallrave me vlerë, kafshëve të gjalla si dhe të materialeve të rrezikshme nëpërmjet avionit për transport mallrash të Turkish Airlines. Ky shërbim i ri ndaj kësaj kategorie mallrash ka për qëllim nxitjen e zhvillimit të biznesit lokal si dhe shënon një arritje mjaft të rëndësishme në historinë e aeroportit.

Drejtori i Përgjithshëm i Operacioneve në TIA Z. Rolf Castro-Vasquez vuri në dukje se zgjerimi i shërbimeve të TIA-s me avionin Airbus 310-300 do t'i lejojë kompanisë mundësimin e përmbushjes më të mirë të kërkesave të tregut shqiptar për transportin ajror të mallrave, duke dhënë gjithashtu edhe ndihmesën për zgjerimin e biznesit lokal. Transportuesi i mallrave është elementi ideal për plotësimin e portofolit të avionëve të TIA-s si dhe një mënyrë e mirë për të zhvilluar transportin ajror të mallrave. Karakteristikat e avionit të kombinuara këto me çmimin e arsyeshëm të transportit si dhe me çmimet tërheqëse të operimit paraqesin mundësi të reja dhe mjaft të mira për klientët e Aeroportit.

Pranimi dhe kujdesi ndaj pasagjerëve me aftësi të kufizuara

Stafi i TIA-s është trajnuar për kujdesin e veçantë ndaj pasagjerëve me aftësi të kufizuara, në përputhje me normat, rregulloren dhe procedurat e TIA-s. Stafi i specializuar i Njësisë së Ndihmës së Shpejtë, i asiston

Reception and care for passengers with reduced mobility

TIA staff is trained to take care for passengers with reduced mobility, in compliance with regulations and TIA procedures. Specialist staff from the First Aid Unit assist these passengers from the moment they enter the terminal to and from the aircraft. Infrastructure and installation of appropriate signage and dedicated areas are available on the premises.

Customer Satisfaction Survey

As part of TIA's efforts to provide a safe, clean and welcoming airport environment, the Company continuously monitors customer feedback and satisfaction. Extensive market research is undertaken through a Customer Satisfaction Survey and direct customer feedback through Comment Cards. Furthermore, information is collected from the Internet via the TIA website (www.tirana-airport.com).



The Customer Satisfaction Survey 2009 was conducted for the third year by an independent company specialized in customer and market research. The information collected from interviews with 1,000 customers and other users of TIA was presented in such report. The 2009 Survey shows that the quality of services and facilities offered by TIA remains generally "very good to excellent" and has been consolidated since the time of the first survey.

Meeting Airport Users

As TIA's main customers, the opinions, comments and suggestions of airlines are very important. Meeting and discussing with airline representatives and getting their opinions on the services offered by TIA, as well as through questionnaires, are considered very important by the company. TIA aims to ensure high quality standards for all of its customers, including both airlines and passengers, while the airlines themselves also aim towards maintaining high quality of service for passengers.

Training, Awareness & Competence

TIA aims to ensure that all employees have appropriate training, awareness and competence, as well as good understanding of how their work potentially affects the quality and environment considered as very important to the success of EQMS. This means first that all responsible directors and managers are fully

këtyre pasagjerëve që në momentin kur ata hyjnë në terminal duke i shoqëruar deri në avion. Infrastruktura dhe instalimi shenjave të domosdoshme për zona të përcaktuara në ndihmë të këtyre pasagjerëve janë në dispozicion dhe mundësohen në momentin kur kërkohet një shërbim i tillë.

Studimi mbi nivelin e kënaqësisë së klientëve

Si pjesë e përpjekjeve të TIA-s për të patur një mjedis sa më mikpritës në Aeroportin "Nënë Tereza" dhe për më tepër të sigurt dhe të pastër, TIA vazhdimisht monitoron reagimet dhe nivelin e kënaqësisë së klientëve. Studime të gjera të tregut janë ndërmarrë përmes anketimeve të pasagjerëve mbi nivelin e kënaqësisë, nëpërmjet informacionit nga Fletët e Përshtypjeve. Veç kësaj, informacioni është mbledhur përmes internetit në faqen e TIA-s (www.tirana-airport.com).

Studimi mbi nivelin e kënaqësisë së klientëve për vitin 2009 u zhvillua, ashtu si anketimet e dy viteve më parë, nga një kompani e pavarur e specializuar në çështje kërkimore mbi tregun dhe klientët. Të dhënat e mbledhura të 1000 pasagjerëve të intervistuar në total në lidhje me klientët dhe përdoruesit e tjerë të TIA-s, janë paraqitur në raportin e përgatitur nga kjo kompani. Studimi i vitit 2009 tregon se standardet në lidhje me cilësinë e shërbimeve dhe faciliteteve të ofruara nga TIA përgjithësisht mbeten të një niveli të lartë dhe këta tregues janë mjaft të konsoliduar krahasuar me anketimet e mëparshme.

Takime me Përdoruesit e Aeroportit

Linjat ajrore konsiderohen si klientët kryesorë të TIA-s, prandaj opinionet, komentet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me shërbimet e ofruara nga kompania janë shumë të rëndësishme. Takimet dhe diskutimet me përfaqësuesit e linjave ajrore për të marrë opinionet e tyre në lidhje me shërbimet e ofruara nga TIA, të siguruara edhe përmes pyetësorëve, konsiderohen si mjaft të rëndësishme për kompaninë. TIA ka për qëllim sigurimin e standardeve të larta të cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj klientëve të saj, përfshirë këtu si linjat ajrore ashtu edhe pasagjerët, ndërsa linjat ajrore në vetvete gjithashtu kanë për qëllim mbajtjen e një niveli të lartë të cilësisë së shërbimeve ndaj pasagjerëve.

Trajnimit, ndërgjegjësimi dhe kompetenca

TIA ka për qëllim të sigurojë që i gjithë personeli të jetë i trajnuar ashtu siç duhet, të jetë i ndërgjegjshëm dhe kompetent, si edhe të jetë i mirëinformuar mbi potencialin dhe ndikimin që ka puna e tyre në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë dhe mjedisit, çka përbën një pjesë mjaft të rëndësishme në funksionimin sa më efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe Mjedisit (EQMS). Kjo do të thotë se, të gjithë drejtorët dhe menaxherët përkatës janë mëse të vetëdijshëm dhe të mirëinformuar për rëndësinë e këtij qëllimi, synimi apo dhe objektivave të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe Mjedisit (EQMS), dhe janë tërësisht të përfshirë në zhvillimin dhe përmirësimin e programit të cilësisë dhe mjedisit.

Departamenti i Burimeve Njerëzore të TIA-s, në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera, identifikon nevojat për trajnime dhe metodat e duhura

aware of the purpose, aims and objectives of EQMS, and are fully involved in the development of the environmental and quality improvement program.

TIA's Human Resources Department, in close collaboration with other departments, identifies training needs and appropriate methods of delivery of training to staff, including contractors, who need to be competent in carrying out their tasks and responsibilities. Moreover, TIA requires contractors and subcontractors to demonstrate a level of competency that complies with TIA policies, objectives and targets.

For a successful implementation of EQMS, the integration of quality, environmental, health and safety training and awareness into training programs is considered crucial. Thus, the QEHS Department cooperates with the HR Department in order to identify QEHS training needs and appropriate trainings to cover them.

Social responsibility

TIA's business activities and services aim to maximize the social, economic and environmental benefits in the broader Airport region. As a sustainable responsible business, TIA has set out quality, environmental, health and safety policies and programs, and has undertaken all measures to meet its commitment towards customers, employees, communities, stakeholders, etc.

The Company has set new standards of air transport in Albania with regard to the quality of services provided and the number of people using the Airport. Furthermore, it has shown to be an important contributor to the economic, social and environmental well-being of the area around the airport as well.

TIA has promoted new practices for increasing business performance through close collaboration with all stakeholders. It has created job opportunities for local residents through its policy of encouraging job applicants from local communities. The Company has employed 84 (30.5%) out of 275 employees from the five communes Rinas, Kruja, Nikël, Preza, Qereke near to the Airport.

Continuous, close cooperation and dialogue characterize TIA's communications with local authorities, businesses and residents. The Company aims to meet its social responsibilities by sponsoring distinguished projects and setting new standards in doing business with care.



në formën e prezantimit të trajnimeve tek stafi, duke përfshirë këtu dhe kontraktorët, të cilët duhet të jenë të aftë dhe kompetentë në kryerjen e detyrimeve të tyre dhe përgjegjësi që ata mbartin. Për më tepër, TIA kërkon nga kontraktorët dhe nënkontraktorët e saj të tregojnë nivelin e duhur të kompetencës që të përputhet gjithashtu edhe me politikat, objektivat dhe synimet e TIA-s.

Për implementimin sa më të suksesshëm të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe Mjedisit (EQMS), integrimi i cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në trajnim dhe në prezantimet për ndërgjegjësim në një program të vetëm trajnimi konsiderohet si mjaft thelbësore. Departamenti i Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë (QEHS), në bashkëpunim me Departamentin e Burimeve Njerëzore, identifikon nevojat për trajnim lidhur me çështjet e cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë dhe organizon trajnimet e duhura për të plotësuar këto nevoja.

Përgjegjësia sociale

Aktivitetet e biznesit të TIA-s dhe shërbimet kanë si qëllim të maksimizojnë përfitimet sociale, ekonomike, dhe mjedisore në të gjithë Aeroportin. Si biznes me përgjegjësi të qëndrueshme, TIA ka përcaktuar programe dhe politika për cilësinë, mjedisin, shëndetin, sigurinë, dhe ka ndërmarrë të gjitha masat për të përmbushur zotimin ndaj klientëve, punonjësve, komunitetit, aktorëve vendimarrës etj.

Kompania ka vendosur standarde të reja të transportit ajror në Shqipëri përsa i përket cilësisë së shërbimit të siguruar dhe numrit të pasagjerëve që përdorin aeroportin. Për më tepër, ka treguar veten si një kontribues i rëndësishëm i interesit ekonomik, social, dhe mjedisor të zonës përreth aeroportit.

TIA ka promovuar praktika të reja për rritjen e performancës së biznesit nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me të gjithë aktorët vendimarrës. Ndër të tjera ka krijuar mundësi për punë për banorët vendas nëpërmjet politikave të saj inkurajuese veçanërisht për komunitetin lokal. Kompania ka punësuar 84 punonjës (30,5%) ndër 275 të punësuar nga pesë zona, të tilla si: Rinas, Krujë, Nikël, Prezë, Qerekë në afërsi të aeroportit.

Vazhdimësia e një bashkëpunimi të ngushtë dhe dialogu karakterizojnë komunikimin e TIA-s me pushtetin vendor, bizneset, dhe banorët vendas. Kompania ka si qëllim të përmbushë përgjegjësitë sociale përmes sponsorizimit të projekteve të veçanta dhe vendosjes së standardeve të reja të kryerjes së biznesit me përkujdesje.

Shkolla 9-vjeçare në Marqinet

Aeroporti, së bashku me aksionerët e HOCHTIEF, ka sponsorizuar rehabilitimin e shkollës 9-vjeçare në Marqinet e cila ka qenë e dëmtuar si pasojë e shpërthimit të municioneve në Gërdec në mars të vitit 2008. Vlerësimi i kujdesshëm i kushteve të shkollës theksoi nevojën për ndërhyrje.

Marqinet nine-year school

The Airport together with its shareholder HOCHTIEF has sponsored the rehabilitation of the nine-year school in Marqinet which had been affected by the explosion of the ammunition facility in Gerdec in March 2008. Careful assessment of the condition of the school highlighted the need for intervention.

The newly transformed and rehabilitated building and ground area in front of the school will support the teaching at the school and provide a child-friendly and appropriate environment for the school children.

Promotion of Albania's economy and tourism

TIA has actively campaigned to promote Albania's economic and tourism development through its participation at the International Tourism fair in Berlin in March 2009 for the third successive year. TIA has found this international media event a valuable instrument in promoting its potential and attracting international attention towards Albania.

Albanian Leadership Award

TIA's corporate citizenship was acknowledged by an Albanian Leadership Award in the category of Private Sector/Business, a prize that TIA received for "...demonstrating high social responsibilities".

Waste/Education

TIA's contractor responsible for waste collection operates in compliance with official standards and regulations and TIA waste management concept based on the principle of safe and environmentally sound waste collection, transportation and disposal at an authorized receptor. TIA has contracted the waste collection company for providing the service at Rinas school as well. Through the service offered to this school, TIA aims to enhance environmental awareness and education for proper waste management.

Charity

Passengers and staff donated EUR 8,500 to people in need through a joint initiative of TIA and Caritas Albania that installed collection boxes for the charity in TIA's new terminal.

In its efforts to create awareness among the Albanian public about making invaluable charity contributions, Caritas, with TIA's agreement, placed collection boxes within the terminal building. The money collected is being used to fund specific initiatives for disadvantaged children in Albania.

Local culture events

The Airport has supported many arts and culture initiatives in Albania, including recently International Contemporary Art Biannual and German October 2009. TIA is continually finding new ways to support cultural initiatives as the Company is committed to providing a better quality of service for passengers, residents and visitors.



Një ndërtesë e re e transformuar dhe rehabilituar si dhe një shesh përpara shkollës do të ndihmojë në kryerjen e procesit mësimor në shkollë, duke siguruar kështu një mjedis të përshtatshëm për fëmijët e shkollës.

Promovim i ekonomisë dhe turizmit shqiptar

TIA ka nxitur një fushatë aktive për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe turizmin nëpërmjet pjesëmarrjes në panairin ndërkombëtar të turizmit në Berlin në mars të vitit 2009 për të tretin vit rradhazi. TIA ka mbështetur këtë ngjarje të medias ndërkombëtare si një instrument i vlefshëm për promovimin e potencialeve të saj dhe tërheqjes së vëmendjes ndërkombëtare në drejtim të Shqipërisë.

Çmimi i Liderit Shqiptar

Kompanisë së TIA-s iu njoh Çmimi i Liderit Shqiptar në kategorinë e sektorit privat/biznes, një çmim që iu dha TIA-s për "...paraqitjen e përgjegjësive të larta sociale".

Mbetjet/Edukimi

Kontraktori i TIA-s për grumbullimin e mbetjeve operon në përputhje me standardet dhe rregulloret zyrtare si dhe në përputhje me konceptet e TIA-s për grumbullimin e mbetjeve të bazuara në principet e sigurisë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të grumbullimit, transportimit dhe hedhjes në vende të autorizuara për sa më sipër. Kompania e nënkontraktuar nga TIA për largimin e mbetjeve grumbullon gjithashtu edhe mbetjet nga shkolla e Rinasit. Përveç këtij shërbimi që i ofrohet shkollës, iniciativa të tilla mjedisore rrisin ndërgjegjësimin në publik dhe përmirësojnë njohuritë e praktikave të mira të menaxhimit të mbetjeve.

Aktivitet bamirësie

Pasagjerët dhe stafi dhuruan 8,500 EUR njerëzve në nevojë përmes një inisiativë të përbashkët të TIA-s dhe Karitasit Shqiptar që bëri të mundur vendosjen e kutive për grumbullim fondesh për bamirësi në Terminalin e ri të TIA-s.

Në përpjekjet për tërheqjen e vëmendjes së publikut shqiptar, Karitasi sipas një marrëveshjeje me TIA-n, vendosi kuti për grumbullime fondesh brenda në terminal për dhënie të një kontributi të dobishëm bamirësie. Paratë e grumbulluara u përdorën për iniciativë të veçanta ndaj fëmijëve në nevojë në Shqipëri.

Ngjarje kulturore

Aeroporti ka mbështetur shumë iniciativë të artit dhe kulturës në Shqipëri, duke përfshirë së fundi "Bienalen Ndërkombëtare të Artit Bashkëkohor" dhe "Javën e Kulturës Gjermane 2009" në Shqipëri. TIA vazhdimisht po gjen mënyra të reja për të mbështetur iniciativë kulturore, ndërkohë që kompania është e angazhuar të sigurojë një shërbim cilësor më të mirë për pasagjerët, vendasit dhe turistët.

Key Figures for year 2009

Shifrat për vitin 2009

In 2009, Tirana International Airport (TIA) reported a double digit growth in terms of passenger numbers, serving 1,394,688 passengers. Passenger numbers increased by 10 per cent compared to 2008 and cargo decreased by 11 per cent. Achievements were recorded also in the number air traffic movements (ATMs), which saw an increase of 5 per cent over the figure for 2008. See table below.

Currently, twelve airlines fly in to and out of TIA, connecting directly the Albanian capital Tirana with 33 destinations.

Në vitin 2009, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) shënoi një rritje dyshifrore përsa i përket numrit të pasagjerëve duke u shërbyer 1,394,688 pasagjerëve. Shifrat e pasagjerëve janë rritur me 10 përqind duke i krahasuar me vitin 2008, ndërsa kargo ka patur një rënie prej 11 përqind. Arritje janë shënuar gjithashtu në numrin e fluturimeve (ATM-ve), të cilat shënuan një rritje prej 5 përqind duke i krahasuar me vitin 2008. Shikoni tabelën që vijon.

Dymbëdhjetë linja ajrore fluturojnë nga TIA dhe në drejtim të saj duke lidhur kështu kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranën, me 33 destinacione.

Key figures and growth in percentage

Shifrat dhe rritja në përqindje

Key Figures/ Shifrat	2008	2009
Passengers/ Pasagjerë	1,267,041 (+ 15 %)	1,394,688 (+ 10 %)
Aircraft movements/ Fluturime	19,194 (+ 5 %)	20,064 (+ 5 %)
Cargo/ Kargo	2,096 tons (- 40 %)	1,863 (- 11 %)



Contact
Kontakt

Alma Bako

Director Quality Environment Health and Safety Department
Drejtoreshë e Departamentit të Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë

E-Mail: abako@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK

**Tirana International Airport Nënë Tereza
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania
Phone: +355 4 2381 600
Fax: +355 4 2381 545
info@tirana-airport.com
www.tirana-airport.com**